



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	10.03.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSATCK	1091/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.31/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.31/2021 të datës 26.01.2021 të parashtruar nga ankuesi [Blank] nga Peja, kundër organit të punësimit/Policisë së Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.31/2021 e datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi [Blank] i punësuar sipas Kontratës Punë për Kohë të Pacaktuar të datës 19.08.2014 në pozitën “Zyrtar për Evidentim-SIPK”, në Drejtorinë Rajonale në Pejë, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës. Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës më datë 15.01.2021 ka nxjerr vendim me të cilin është shpall in kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit me arsyetim në bazë të nenin 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankesat parashtrohen drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi më datë 16.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për mos përfshirje në pakon emergjente për muajin nëntor 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Policinë e Kosovës. Më datë 04.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Policia e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 305/2021 të datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.02.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 15.01.2021; Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 14.07.2014; Përshkrimi i detyrave të punës 14.07.2015; Lista e Zyrtarëve të angazhuar në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020; Lista e Punës mujore; Vendimin me Nr. 02/32 o datës 25.09.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kartela e nëpunësit 2020 dhe 2021; Vendimi i datës 15.01.2021 i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës; Vendimin Nr. 02/52 të datës 24.12.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Përgjigjen në ankesë e datës 04.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, të cilët pretendojnë që institucioni nuk i ka kompensuar nga pakoja emergjente për muajin nëntor 2020, ka konstatuar që në bazë të Vendimit me Nr. 02/32 të datës 25.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pikën 1 përcaktohet se: *“Ndahen mjete shtesë financiare në vlerën prej 3,989,423E (tre milion e nën qind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre euro) sipas kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme/ Policisë së Kosovës, për angazhimin e shtuar dhe punë me orar të zgjatur në terren të zyrtarëve policor aktiv, në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejtë ndaj pandemisë covid-19”,* po ashtu në bazë të Vendimit Nr. 02/52 të datës 24.12.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pikën 1 përcaktohet se: *“Ndahen mjete shtesë financiare në vlerën prej 1,598,100.00E (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e njëqind euro) në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe shtesa”, për organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, nën programi “Shërbimet Administrative” me kod 30000, për zyrtarët aktiv policor për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejtë në zbatimin e detyrave në menaxhimin e pandemisë COVID-19, sipas kërkesës dhe listës së bashkangjitur nga Ministria e Punëve të Brendshme”,* mbi bazë të kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se në bazë të këtyre vendimeve kjo shtesë i është njohur vetëm atyre personave që janë drejtpërdrejtë të rrezikuar nga infektimit me COVID-19, respektivisht zyrtarëve policor aktiv në terren.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se përveç pozitive të lartcekura në vendim, pozitat e tjera nuk janë të përfshira në pakon emergjente dhe si të tilla nuk kanë mund të realizojnë shtesën e pretenduar, ndërsa ankuesi po ashtu edhe institucioni nuk kanë ofruar asnjë dëshmi me të cilin dëshmohet se ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit siç pretendon.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.31/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.